



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1133/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Muhamet Ajeti vëzhgues nga subjekti politik Lëvizja për Bashkim dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Muhamet Ajeti nga Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Muhamet Ajetivëzhgues i Lëvizjes për Bashkim me të cilin ai pretendon se në qendrën e votimit 1920E/03 LB-ja i ka pasur 36 vota prej të cilave kandidati Musë Bislimi i cili kishte numrin 22-LB ka pasur gjithsejt 26 vota të numëruara në vendvotim. Ku sipas rezultateve të KQZ-së në këtë vendvotim del se kandidati në fjalë Musë Bislimi ka 0 (zero) vota, ku në këtë rast mungon edhe vota personale e kandidatit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Muhamet Ajeti nga komuna e Prishtinës. PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1133/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.